

**SISTEMI I MBLEDHJES DHE RAPORTIMIT TË INFORMACIONIT SHËNDETËSOR TË
REGJISTRAVE MJEKËSORE**



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	4
Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit.....	4
NËNSHKRIMET MIRATUESE.....	4
Të dhënat e personit të Kontaktit:	4
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues	5
1.2. Historiku.....	5
1.3. Situata Aktuale në Sektor	5
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	6
2.1. Objektivi i Përgjithshëm.....	6
2.2. Qëllimi.....	6
2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori	7
3. SUPOZIMET DHE RISQET.....	7
3.1. Supozimet e Projektit	7
3.2. Risqet	8
4. QËLLIMI I PUNËS.....	8
4.1. Të Përgjithshme.....	8
4.1.1. Përshkrimi i detyrës	8
4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet	9
4.1.3 Grupet e synuara	9
4.1.4 Siguria e sistemit.....	99
4.2. Detyrat specifike	10
5. LOGJISTIKA DHE KOHA.....	11
5.1. Vendndodhja	11
5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	11
6. RAPORTIMI.....	11
6.1. Kërkesat e Raportimit.....	11
6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	11
7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA	12
8. Garancia	14
9. MIRËMBAJTJA	14
10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT.....	18
11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	19

12.	TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	19
13.	KËRKESAT FUNKSIONALE.....	20
13.1.	Raporte.....	27
14.	KËRKESAT TEKNIKE	27
15.	Aneks – Te dhenat e regjistrave mjeksore	29



FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Miratoi:
Projektit

Drejtuesi i

Miratoi:
TIK

Përgjegjës për Proceset

<Emri Mbiemri>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

<Nënshkrimi>

Përgatiti:
TIK

Përgjegjësi

Përgatiti: <Funksioni i Anëtarit të Grupit të Punës për Hartimin e Termave të referencës, mund të shtohen të tjerë>

<Emri Mbiemri>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

<Nënshkrimi>

Person kontakti:

Rishikoi: Përgjegjësi i Sigurisë së TIK-ut

<Emri Mbiemri>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

<Nënshkrimi>

Të dhënat e personit të Kontaktit:

<Në tabelën e mëposhtme duhet të paraqitet informacioni në lidhje me zyrtarin që përgatit specifikimet teknike.>

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Adresa e-mail	

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

-Ministria e Shëndetësisë

1.2. Historiku

Prej vitesh, në mënyrë manuale, mbledhet informacion shëndetësor nga strukturat përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i shëndetit Publik, INSTAT etj. Informacioni shëndetësor paraqitet i fragmentuar, me cilësi jo të verifikueshme dhe është mbështetur dobët, deri fare, në sisteme të teknologjisë të informacionit.

Mbi informacionin e mbledhur përlogariten dhe indikatorët e performancës të:

1. Situatës shëndetësore në vend
2. Funksionimin e sistemit shëndetësor

Mbi informacionin e mbledhur, kryen dhe raportimet përkatëse dhe në organizata ndërkombëtare në bazë të konventave të ndryshme që ka Shqipëria (Organizata Botërore e Shëndetësisë, donatorë të ndryshëm, etj)

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Tipi i informacionit shëndetësor që do të grumbullohet dhe raportohet nga ofruesit e kujdesit shëndetësor klasifikohet në 3 kategori kryesore:

- regjistrat e sëmundjeve jo të komunikueshme
- survejanca e sëmundjeve infektive
- veprimtaria e institucionit (llojshmëri shërbimesh dhe volum shërbimesh, burimet njerëzore).

Ky informacion në qendrat shëndetësore, aktualisht është vetëm në format letër.

Aktualisht MSH ka në përdorim regjistrin e saj elektronik, Sistemin Informatik për Regjistrimin dhe Kontrollin e Barnave mjeksore(SIRKB) në Republikën e Shqipërisë.

Kërkohej që në tënjëjtën infrastrukturë tëimplementohen dhe regjistrat shëndetësorë që klasifikohen në 3 kategori kryesore:

- regjistrat e sëmundjeve jo të komunikueshme
- survejanca e sëmundjeve infektive
- veprimtaria e institucionit (llojshmëri shërbimesh dhe volum shërbimesh, burimet njerëzore).

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivat e këtij projekti përfshijnë.

- Filtrim kompleks i të dhënave në mënyrë që të shmangen të dhënat e gabuara ose shumëfishe.
- Integrim të dhënash nga burime të ndryshme informacioni sipas një modeli referimi standard për të gjithë burimet e të dhënave
- Procesim të të dhënave në kuadër të përmirësimit të cilësisë së të dhënave, duke refuzuar në model të dhënat që janë jo të ‘pastra’
- Validim të të dhënave sipas mbajtjes së tabelave satelite referenciale.
- Transformim të të dhënave sipas rregullave specifike të domainit të shëndetësisë.
- Agregim të të dhënave nisur nga të dhëna të detajuara.
- Ndërtimit e fushave llogaritëse, të shumatoreve dhe variancave të të dhënave

Tipi i informacionit shëndetësor që do të grumbullohet dhe raportohet nga ofruesit e kujdesit shëndetësor klasifikohet në 3 kategori kryesore:

- regjistrat e sëmundjeve jo të komunikueshme
- survejanca e sëmundjeve infektive
- veprimtaria e institucionit (llojshmëri shërbimesh dhe volum shërbimesh, burimet njerëzore).

Në tërësi, sipas VKM-së, numërohen 49 çështje për të cilat pritet të merret informacion periodik dhe i rregullt. Ndërsa survejanca e sëmundjeve infektive dhe veprimtaria e institucionit përbëjnë kategori tradicionale të informacionit shëndetësor, regjistrat e sëmundjeve jo të komunikueshme përbëjnë risi dhe sfida, bazuar kjo edhe në Programin e Qeverisë për Shëndetësinë 2013-2017.

Regjistrat janë sisteme informacioni që përmbajnë të dhëna uniforme për individë të veçantë, të mbledhura në vijimësi në mënyrë sistematike dhe të studiuar me qëllimin për t'i shërbyer formulimit të politikave shëndetësore dhe kërkimit shkencor.

Gjithashtu, me konsolidimin e sistemit të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimit të kujdesit shëndetësor publik ose privat, krijohet mundësia për ndërtimin e raporteve statistikore sipas fushave të regjistrave mjekësorë të institucioneve të kujdesit shëndetësor.

2.2. Qëllimi

Qëllimi i projektit, që propozohet, është i domosdoshëm në kushtet kur sistemet e informacionit shëndetësor aktualisht janë të fragmentuara, me cilësi jo të verifikuar dhe të mbështetura dobët në teknologjinë e informacionit. Neni 30 pika 1 i ligjit Nr.10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton ngritjen e sistemit unik të informacionit shëndetësor i cili ka akses në të gjitha institucionet që mbledhin të dhënat shëndetësore. Ndërkohë, zhvillimi i shërbimeve shëndetësore në sektorin privat, kërkon rregullime në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave. Dinamikat e zhvillimeve të brendshme dhe bashkëveprimi me organizma ndërkombëtare, kërkojnë gjithashtu përshtatjen e sistemeve

të informacionit shëndetësor në mënyrë të tillë që të dhënat të jenë të analizueshme dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar.

Sistemi informatik do të ketë si qëllim

- regjistrimin
- integrimin
- konsolidimin
- raportimin

e të dhënave të institucioneve të kujdesit në një bazë të dhënash të integruar.

"Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit ."

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Rezultatet e këtij projekti që duhet të arrihen nga kontraktori përfshijnë

- Ndërtimi i një baze të dhënash për regjistrat mjekësorë objekt i këtij projekti.
- Ndërtimi i një sistemi informatik, aplikacion web, i pajisur me web service (për ndërveprim) për popullimin e regjistrave mjekësore nga institucionet shëndetësore.
- Sistemi informatik i regjistrave mjekësorë duhet të ketë një modul raportimi të dhënash të regjistrave mjekësorë.
- Ndërtimi i një aplikacioni informatik që do t'u ekspozohet punonjësve të institucioneve shëndetësore për të populluar të dhënat e regjistrave nëpërmjet një infrastrukture të sigurtë qeveritare bazuar në infrastrukturën e PKI-së të AKSHI-t.
- Vënie në punë e aplikacionit informatik të regjistrave mjekësorë në infrastrukturën ekzistuese në datacenterin e MSH.
- Implementimet në DIS për ndërveprimin.
- Ofrimi i USB tokens për PKI e punonjësve të institucioneve shëndetësore që do të përdorin sistemin.
- Trajnim e stafit.
- Ofrim i shërbimeve të mirëmbajtjes.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Staf i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik të jenë të pavarur në punën e tyre dhe të gjindshëm në çdo rast.
- Staf i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe bashkëpunues me njëri-tjetrin.

- Stafi i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet.
- Stafi i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik të jetë i aftë dhe origjinal në zgjidhjen e problemeve
- Stafi i autoritetit kontraktor do të vërë në dispozicion të personelit të operatorit ekonomik të gjithë dokumentat, rregulloret, procedurat e nevojshme për realizimin e rregullave të biznesit objekt i këtij projekti.
- Informacioni i shkëmbyer midis stafit të palëve mbetet konfidencial mes palëve

3.2. Rrisqet

Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës me punës së stafit të MSH

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

VKM Nr. 327, datë 28.5.2014 "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat".

Pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Ligj Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

VKM Nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

Ligj Nr.10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore ", si dhe VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore ".

Në tërësi, sipas VKM-së, numërohen 49 çështje për të cilat pritet të merret informacion periodik dhe i rregullt. Ndërsa survejanca e sëmundjeve infektive dhe veprimtaria e institucionit përbëjnë kategori tradicionale të informacionit shëndetësor, regjistrat e sëmundjeve jo të komunikueshme përbëjnë risi dhe sfide, bazuar kjo edhe në Programin e Qeverisë për Shëndetësinë 2013-2017.

Qendër kombëtare për grumbullimin, analizën dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave është Instituti i Shëndetit Publik, sikurse përcaktohet në Ligjin nr.10138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik". Në Institutin e Shëndetit Publik funksionon Observatori Epidemiologjik. Fluksi i të dhënave do të ushqejë Observatorin Epidemiologjik për analizë dhe profilizim të gjendjes dhe prirjes së shëndetit të popullatës. Regjistrat e Sëmundjeve nënkuptojnë metodologji, kapacitete teknike, burime njerëzore dhe bashkëveprim të shumë hallkave.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Detyra e Operatori Ekonomik, është që të realizojë zhvillimin, lëvrimin, instalimin, konfigurim, testimin dhe vënien në punët aplikacionit informatik të regjistrave mjekësorë në infrastrukturën ekzistuese në datacenterin e MSH. Duhet të realizohet dhe implementimi në DIS për ndërveprimin e aplikacionit informatik me platformën qeveritare të ndërveprimit.

Aplikacioni informatik duhet të mundësojë ruajtjen dhe përpunimin e informacionit për regjistrat mjekësorë nëpërmjet furnizimit të informacionit duke përdorur Web Service si dhe duke mundësuar regjistrimin (popullimin) e të dhënave në mënyrë manule (data entry).

Qasja në aplikacionin informatik e punonjësve të institucioneve shëndetësore do të realizohet duke përdorur USB tokens të pajisura me PKI (Gjenerimi i PKI-së për këta punonjës do të realizohet pranë infrastrukturës ekzistuese të PKI që AKSHI ka në përdorim.)

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqipërisë.

4.1.3 Grupet e synuara

- Stafi i MSH
- Stafi i DSHP
- Stafi i Spitaleve

4.1.4 Siguria e sistemit

Në sistemin software, do të realizohet autentifikim me mekanizma Login me username/password duke përdorur platformën single-sign-on që AKSHI disponon. Sistemi duhet të jetë i aftë që të suportojë dhe loginin me PKI (token) <http://www.akshi.gov.al/pki>.

Identifikimi do të duhet të bëhet nëpërmjet USB token, në të cilën është instaluar çelësi publik dhe certifikata dixhitale për administratën publike, e lëshuar nga AKSHI për punonjësit qeveritarë. Operatori ekonomik duhet të realizojë dhe implementimin e loginit në sistem që kërkohet të prokurohet duke përdorur infrastrukturën PKI që AKSHI disponon. Loginin me PKI do të ofrohet vetëm për personelin e spitaleve dhe DSHP që do të përdorin aplikacionin informatik të regjistrave mjekësorë.

Sistemi informatik duhet të jetë i aftë që për përdoruesit e tjerë (që nuk do të logohen me USB tokens), të ofrojë dhe mundësinë e loginit të punonjësve qeveritarë me fjalëkalim duke përdorur infrastrukturën Single Sign On (SSO) që AKSHI ofron për punonjësit qeveritarë.

Identifikimi do të bëhet nëpërmjet të njëjtave kredenciale: emër, mbiemër dhe fjalëkalim, që përdoren për aksesimin në hapësirën e kompjuterit dhe email-it (gov.al) të institucionit qeveritar ku ju punoni. Kjo mënyrë identifikimi ju lejon të gjithë punonjësve të Ministrisë të Linjës dhe Institucioneve të varësisë, të cilat janë të përshira në domain-in "gov.al" në Active Directory-në, e cila administrohet nga AKSHI.

Sistemi do të mbajë informacion të rëndësishëm për institucionin i cili do të vijë në ndihmë të qytetarit. Siguria e sistemit mbështetet mbi atributet Besueshmëri, Integritet dhe Disponueshmëri. Siguria e hardware dhe software duhet të jetë e bazuar në VKM 945 datë 02.11.2012, neni 18.

Disponueshmëria e sistemit do të jetë D2 - disponueshmëria - 99% (ndërprerja totale e lejueshme në një javë ~ 2 orë); vonesa e lejueshme e kohës së reagimit të kërkuar në pikun e ngarkesës - minuta (1÷10);

Integriteti i sistemit do të jetë I2 - integriteti, ekzistenca e ndryshimeve apo dëmtimeve është e zbulueshme; verifikimi periodik i saktësisë, kërkohet integriteti dhe përditësimi i informacionit;

Niveli i konfidencialitetit të sistemit do të jetë K1 - informacion për përdorim të brendshëm: aksesi i informacionit lejohet me kusht që personi, i cili kërkon të përdorë të dhënat ka një interes legjitim për to;

Klasa e sigurisë së sistemit do të jetë M-D2I2K1

Sistemi duhet të ofrojë minimalisht

- Mekanizmi i Autentifikimit - Sistemi duhet të sigurojë një mekanizëm për sigurinë që përfshin autentifikimin dhe autorizimin.
- Identitetet dhe të drejtat - Sistemi duhet të ofrojë një regjistër qendror për të gjitha rolet, përdoruesit dhe të drejtat e tyre.
- Mekanizmi i autorizimit - Sistemi duhet të sigurojë një mekanizëm autorizimi në bazë të përdoruesit dhe roleve. Sistemi duhet të lejojë apo refuzojë aksesin në funksionalitetet e ndryshme të sistemit, bazuar në anëtarësimin e përdoruesve për çdo rol.
- Mekanizmi i auditimit - Sistemi duhet të ruajë gjurmët e përdoruesve të regjistruar të cilët modifikojnë të dhënat në bazën e të dhënave. Sistemi duhet të sigurojë gjurmimin për të gjithë veprimet që kanë lidhje me krijimin, miratimin, refuzimin, dhe pezullimin e regjistrimit.

Siguria e sistemit do të aplikohet në disa nivele:

Në nivel sistemi:

- Çdo përdorues do të autentifikohet në sistem. Të dhënat sensitive si fjalëkalimet dhe emri i përdoruesit do të jenë të enkriptuara në bazën e të dhënave;
- Infrastruktura e aplikimit të sigurisë do të përdorë Role, Autorizime dhe Politika të Aksesit të të Dhënave për të përcaktuar dhe kontrolluar veprimtarinë e përdoruesve. Çdo përdorues mund të ketë një apo më shumë Role të cilat mundësojnë atë të kryejë një grup të caktuar aktivitetesh.

Sistemi i sigurisë do të mundësojë që roleve funksionale të përdoruesve në institucion t'i vërë në dispozicion role informatike, në mënyrë që çdo përdorues të ketë akses dhe autorizim për të kryer çka është përcaktuar në përshkrimin e punës dhe detyrat funksionale që ai ka.

4.2. Detyrat specifike

Kontaktori ka si detyrë për realizimin e projektit sa më poshtë shënohet:

- Zhvillim, Lëvrim, Instalim, Konfigurim, Testim dhe vënie në punë e aplikacionit informatik të regjistruarve mjekësorë në infrastrukturën ekzistuese në datacenterin e MSH.
- Implementimi në DIS për ndërveprimin e aplikacionit informatik me platformen qeveritare të ndërveprimit
- Trajnim për sistemin për stafit (sipas metodës Trajnoj Trajnuesit)
- Ofrimi i USB tokens për PKI e punonjësve të institucioneve shëndetësore që do të përdorin aplikacionin
- Ofrim i shërbimeve të mirëmbajtjes pas periudhës së implementimit dhe vënies në punë, për një periudhë 4 vjeçare.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Ne infrastrukturën ekzistuese në Datacenter-in e MSH

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Si datë fillimi e projektit do të merret “Data e nënshkrimit të kontratës” dhe periudha e implementimit do të jetë 4 muajnisur nga kjo datë.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

- Kërkohet nga kontraktuesi të dorëzojë dokumentacionin e bazës së të dhënave (për sa i takon kontraktuesit) sipas kërkesave të nëneve 11 dhe 13 të VKM-së 945.

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në <shqip> në origjinal dhe <2(dy)> kopje:

- Raporti Fillestar prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas <1(një) muaji> nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- Drafti i raportit përfundimtar i faqeve maksimale <20(njëzet)> (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset) Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- Raporti final me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është <5(pesë)> ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi <Sistemin >. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet sëbashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Në procedurat e centralizuara, si një praktikë standarde përfituesi duhet të përfshihet në komentet dhe miratimin e raporteve. Në mungesë të komenteve ose miratimit nga përfituesi brenda afatit të caktuar, raportet konsiderohen të aprovuara.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Aplikacionet softwaredo të hostohen në infrastrukturën e vënë në dispozicion nga MSH.

Pupullimi i Regjistrave do të behet duke u bazuar në të dhenat primare që vihen në dispozicion nepermjet infrastrukturës së ndërveprimit ESB (Enterprise Service Bus i Qeverisë Shqiptare), platformës unike qeveritare të ndërveprimit.

Aplikacionet software që do të ndërtohen duhet të ndërveprojnë me platformën unike qeveritare të ndërveprimit pranë AKSHI-t, për të siguruar komunikim me sisteme të tjera, dhe konkretisht me:

Sistemin e Regjistrat Kombëtar të Gjëndjes Civile

- Fusha hyrëse
 - NID
- Fushat dalëse:
 - NID
 - Emri
 - Mbiemri
 - Atësia
 - Rruga
 - Gjinia
 - Vendlindja
 - Datalindja
 - Mëmësia
 - Kodizgjc
 - Gjendja Civile
 - EmriNJQV
 - Lidhje Me Kryefamiljarin
 - Rrethi
 - Qarku



Sistemin e Qendrës Kombëtare të Biznesit

- Fusha hyrese
 - NUIS
- Fushat dalese:
 - NUIS
 - Emri i subjektit
 - Aktiviteti
 - Data regjistrimit
 - Status i Subjektit
 - Adresa e Subjektit
- Sistemin e DPT(per te dhenat e punesimit)
- Fusha hyrese
 - NID
- Fushat dalese:
 - NUIS ku eshte eshte i punesuar
 - Emri i subjektit
 - Pozicioni i punes



Sistemin e ISSH(për të dhënat e Pensionistëve)

- Fusha hyrese
 - NID
- Fushat dalese:
 - Tipi i pensionit qe perfiton
 - Data e fillimit te pensionit
 - Vlera e perfitimit

Sistemin e FSDKSH(për të dhënat e Kategorisë së pacientëve)

- Fusha hyrese
 - NID
- Fushat dalese:
 - Kategoria e Pacientit
 - Vlefshmeria e kategorie date nga

- Vlefshmeria e kategorise date deri

Aplikacioni software do te ekspozoje informacion ne platformen qeveritare te nderveprimit, per institucionet e shendetesore si me poshte vijon:

Fushat hyres:

<NID>

Fushat dalese:

<ID e regjistrimit mjeksor ku pacienti ben pjese>

<Data e regjistrimit te pacientit ne regjistrin shendetesor>

<Emertimi i regjistrimit mjeksor ku pacienti ben pjese>

<Vlerat mjeksore te regjistrimit mjeksor ku pacienti ben pjese>

Nderveprimi nepermjet platformes unike qeveritare te nderveprimit do te lejoje shkembimin e mesazheve elektronike ndermjet Government Gateway dhe sistemeve te brendshme backend. Infrastruktura mbeshtetese qe sherben per te shkembyer informacion me Platformen Qeveritare te Nderveprimit eshte DIS (Department Integration Server). Kjo nenkupton qe cdo institucion qeveritar me te cilin do te ndeveprohet duhet te ketë një DIS në mënyrë që të mundësojë komunikimin për sistemet e brendshme të informacionit me sistemet e informacionit të agjensive të tjera. Për të mundësuar komunikimin e sistemit, jo vetëm me institucionet që tashmë kanë sisteme elektronike, por edhe me institucione të tjera që nuk kanë ende, duhet që sistemi që do ndërtohet të jetë në gjendje që të lidhet me komponenten DIS (Department Integration Server) të platformës së ndërveprueshmërisë (ESB - Enterprise Service Bus), për të mundësuar shkëmbimin e informacionit me palët e treta, infrastrukturë e cila aktualisht është operacionale pranë AKSHI-t.

Aktualisht MSH ka ne perdorim DIS-in e saj qe ndodhet ne infrastrukturen ekzistuese ne datacenter-in e MSH.

8. Garancia

Nuk Aplikohet

9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes se sistemit do të jetë 4 vjet, në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofroje shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë.

(a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-t e listuara në tabelën e listës së furnizimeve të percaktuar në kapitullin “9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT”. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë AUTORITETI KONTRAKTOR, përveç rasteve kur AUTORITETI KONTRAKTOR përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

(b) Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e AUTORITETIT KONTRAKTOR). Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i AUTORITETI KONTRAKTOR (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i AUTORITETI KONTRAKTOR dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. AUTORITETI KONTRAKTOR do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë AUTORITETI KONTRAKTOR dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i AUTORITETI KONTRAKTOR. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, AUTORITETI KONTRAKTOR do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga operatori ekonomik, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. AUTORITETI KONTRAKTOR do të koeprojë me kërkesën e operatorit ekonomik për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të dërgojnë një Teknik Shërbimi pranë AUTORITETI KONTRAKTOR brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga AUTORITETI KONTRAKTOR dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autoritetit kontraktor, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

(iii) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit. Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjdhur në mënyrë të tërthortë”, (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Operatori ekonomik të përcaktojë së problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin në

konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Tekniket e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesit.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas nderhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e Autoritetit Kontraktor për çdo ndërhyrje.

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me AUTORITETIN KONTRAKTOR një axhendë periodike kontrollesh mujore si më poshtë:

- a. Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve me kritike të infrastrukturës së klientit
- b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware / software
- c. Rishikim i të dhënave mbi performancë e serverave
- d. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware

Kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë periudhës së mirëmbajtjes

Serioziteti 1 (Kritik/ i Lartë)	Serioziteti 2 (I Mesëm)	Serioziteti 3 (I Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare të konsiderushme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, por ata janë në gjëndje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë një pjesë të vogël të punës së tyre, por ata janë në gjëndje të realizojnë pjesën tjetër
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon në 1 (një) ose 2 (dy) përdorues

Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2]		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër)	Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
Brenda një ore	Brenda 8 (tetë)	Brenda 8 (tetë) orëve ose ditën tjetër të punës.
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë të vazhdueshme pas kontaktit të parë.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 ditëve të vazhdueshme të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 ditë kalendarike.



10.KOMPONENTET PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

1	2	3	4
Nr	Përshkrimi	Njesia	Sasia
1	Zhvillim,Levrim, Instalimin,Konfigurim,Testim dhe venie ne pune e aplicacionit informatik ne infrastrukturen ekzistuese ne datacenterin e MSH (SISTEMI I MBLEDHJES DHE RAPORTIMIT TË INFORMACIONIT SHËNDETËSOR TE REGJISTRAVE MJEKSORE)	SET	1
2	Implementimi ne DIS per nderveprimin e sistemit informatik me platformen qeveritare te nderveprimit	cope	1
3	Trajnim per sistemin per stafit (Trajno trajnuesit)	SET (5 ditor)	1
4	USB tokens per PKI e punonjesve te insitucioneve shendetesore	cope	85
5	Ofrim i sherbimeve te mirembajtjes pas periudhes se implementimit dhe venies ne pune	vit	4

11.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5-M52
1	Faza përgatitore për sistemin software	x				
2	Faza e zhvillimit dhe implementimit të sistemit software		x	x		
3	Faza e integritimit dhe testimit të sistemit software			x	x	
4	Trajnimi i përdoruesve				x	
5	Marrja në dorëzim				x	
6	Mirembajtje 4 (vjet)					x

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe dokumentacionin teknik do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Sistemi do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, së bashku me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të moduleve në veçanti dhe dokumentin teknik në tërësi.

Public Health Sector

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Tëpërgjithshme

SISTEMI I MBLEDHJES DHE RAPORTIMIT TË INFORMACIONIT SHËNDETËSOR TË REGJISTRAVE MJEKËSORE DUHET:

- Te jete web based.
- Te perballoje nje numer shume te madh aplikimesh per licnesim.
- Te suportoje baza te ndryshme te dhenash te tipit RDBMS.
- Te jete i pavarur nga platforma, pra te mund te instalohet ne sisteme operative Windows dhe Linux sipas nevojës.
- Te kete nje nderfaqe te thjeshte dhe te lehte ne perdorim.
- Te kete kontroll te aksesit, te bazuar ne role, me nje nderfaqe te thjeshte menaxhimi.
- Te kete mundesine e krijimit dhe perdorimit te workflows ne sistem per menaxhimin e proceseve te punes.
- Te kete kerkim te indeksuar.
- Te kete mundesine e kerkimit me ane te fushave te ndryshme per te thjeshtuar gjetjen e dokumentit ne sistem.
- Te ofroje mundesi integrimi me ane te web services.
- Te jete i ndertuar ne menyre modulare, me mundesi te shtimit apo heqjes te moduleve te ndryshme, si edhe te kete mundesine per te zhvilluar module te reja.
- Te ofroje API per zhvillimin e funksionaliteteve shtese.
- Software-i duhet të jetë i bazuar në web-based dhe baza e të dhënave RDBMS;
- Software-i duhet të përdorë teknika të avancuara për optimizimin e përdorimit të RDBMS për të garantuar performancë optimale me rritjen e sasisë së të dhënave;
- Furnizuesi duhet të sigurojë dhe të mbështesë arkitekturë të orientuar ndaj e-sherbimeve (e-Service oriented architecture) ;
- Software-i duhet të jetë i aksesueshëm nga shfletuesit e ndryshem si: Mozilla Firefox, Google Chrome, Internet Explorer, Opera dhe Safari;
- Software-i duhet të jetë i aksesueshëm pavarësisht sistemit të shfytëzimit që përdor kompjuteri i përdoruesit;
- Software-i duhet të jetë në gjuhën shqipe.
- Software-i qëndror duhet të jetë funksional në sistemin e operimit Windows 2008 e lart, Linux, etj;
- Software-i duhet të përfshijë komponentë për dedektimin e hyrjeve të paautorizuara dhe bllokimin automatik të tyre
- Software-i duhet të siguroj një seri mesazhesh që sinjalizojnë dhe orientojnë përdoruesin gjatë kryerjes së veprimeve;
- Software-i duhet të shoqerohet me manual të plotë në gjuhën shqipe për përdorimin e tij.

Sistemi software duhet te mundesoje ruatjen dhe perpunimin e informacionit per regjistrat mjeksore si me poshte vijon:

1. Regjistri i kancerit;
2. Regjistri i diabetit;
3. Regjistri spitalor për sëmundjet e arterieve koronare (SAK);
4. Regjistri spitalor për aksidentet cerebro-vaskulare (ACV);
5. Regjistri i sëmundjeve të rralla;
6. Regjistri i kontrollit mjekësor bazë, për 40-65 vjeç;
7. Regjistri i defekteve të lindura;
8. Regjistri i abortit;
9. Regjistri i shërbimeve të trajtimit të problemeve të varësive toksikologjike dhe adiktologjike (drogat);
10. Regjistri i sindromit të imunodeficiencës së fituar (AIDS);
11. Regjistri për personat që testohen për HIV;
12. Planifikimi familjar;
13. Raportimi javor i sindromave infeksioze;
14. Raportimi dhe denoncimi specifik i sëmundshmërisë infektive;
15. Survejanca sindromike e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST);
16. Survejanca e gripit;
17. Vaksinimi;
18. Farmakovigjilenca: raportimi i reaksioneve pasvaksinore;
19. Hemovigjilenca;
20. Survejanca e meningo - encefaliteve;
21. Survejanca e poliomyelilit: paralizat flakside akute (PFA);
22. Survejanca e rubeolës kongenitale;
23. Survejanca e rashit makulo-papular me temperaturë;
24. Survejanca e etheve hemoragjike;
25. Survejanca e sigurisë së gjakut;
26. Evidentimi dhe raportimi i shpërthimeve epidemike;
27. Sëmundshmëria në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor;
28. Sëmundshmëria spitalore;
29. Vdekshmëria spitalore;
30. Vdekshmëria nën 5 vjeç;
31. Raportimi i dhunës në familje;
32. Veprimtaria e shërbimeve të kujdesit parësor;
33. Veprimtaria e shërbimit stomatologjik;
34. Veprimtaria e institucioneve me shtretër;
35. Veprimtaria obstetrikale në institucionet shëndetësore ose banesë;
36. Veprimtaria e qendrave shëndetësore të specializuara ose poliklinikave;
37. Veprimtaria e shërbimit të urgjencës;
38. Veprimtaria e konsultorit të gruas;
39. Veprimtaria e konsultorit të fëmijëve;
40. Veprimtaria e laboratorit mikrobiologjik;
41. Veprimtaria e laboratorit kimik - fizik (Shëndetit Publik);
42. Veprimtaria e dispanserive antituberkulare;
43. Veprimtaria e laboratorit klinik biokimik;
44. Veprimtaria e Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut;


45. Veprimtaria e qendrave komunitare të shëndetit mendor;
46. Veprimtaria e shtëpive të mbështetura të shëndetit mendor;
47. Veprimtaria e institucioneve të shëndetit mendor me shtretër;
48. Veprimtaria e transplantimit;

Fushat që duhet të ruhen dhe perpunohen janë të specifikuara në mënyrë të detajuar në kapitullin Aneks 1 të dokumentit të specifikimeve teknike.

Sistemi software duhet të mundësojë ruajtjen dhe perpunimin e informacionit për regjistrat mjeksore nëpërmjet furnizimit të informacionit duke përdorur Web Service si dhe duke mundësuar regjistrimin (popullimin) e të dhënave në mënyrë manule (data entry).

Proceset e punës në aplikacionin informatik





- Perdoruesi Logohet ne sistem
- Behet kontroll mbi te drejatat dhe rolet qe ka perdoruesi ne aplikacionin informatik
- Ne qofte se ka te drejta vijon punon, ne te kundert perdoruesit i duhen caktuar te drejatat dhe rolet per te punuan ne aplikacionin informatik
- Ne qofte se ka te drejta vijon punon duke zgjedhur tipin e regjistrimit mjeksor per plotesim

- Pasi ka zgjedhur tipin, ploteson te dhenat e regjistrave
- Perdoruesi numd te gjeneraoje statistika dhe raporte mbi te dhenat e regjistrave mjeksore te regjistruar ne aplikacionin informatik

Operatori ekonomik duhet te ofroje mundesine e furnizimit te informacionit me web service per regjistrat mjeksore si me poshte vijon:

1. Regjistri i kancerit;
2. Regjistri i diabetit;
3. Regjistri spitalor për sëmundjet e arterieve koronare (SAK);
4. Regjistri spitalor për aksidentet cerebro-vaskulare (ACV);
5. Regjistri i sëmundjeve të rralla;
6. Regjistri i kontrollit mjekësor bazë, për 40-65 vjeç;
7. Regjistri i defekteve të lindura;
8. Regjistri i abortit;
9. Regjistri i shërbimeve të trajtimit të problemeve të varësive toksikologjike dhe adiktologjike (drogat);
10. Regjistri i sindromit të imunodeficiencës së fituar (AIDS);
11. Regjistri për personat që testohen për HIV;
12. Planifikimi familjar;
13. Raportimi javor i sindromave infeksioze;
14. Raportimi dhe denoncimi specifik i sëmundshmërisë infektive;
15. Survejanca sindromike e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST);
16. Survejanca e gripit;
17. Vaksinimi;
18. Farmakovigjilenca: raportimi i reaksioneve pasvaksinore;
19. Hemovigjilenca;
20. Survejanca e meningo - encefaliteve;
21. Survejanca e poliomielitit: paralizat flakside akute (PFA);
22. Survejanca e rubeolës kongenitale;
23. Survejanca e rashit makulo-papular me temperaturë;
24. Survejanca e etheve hemoragjike;
25. Survejanca e sigurisë së gjakut;
26. Evidentimi dhe raportimi i shpërthimeve epidemike;
27. Sëmundshmëria në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor;
28. Sëmundshmëria spitalore;
29. Vdekshmëria spitalore;
30. Vdekshmëria nën 5 vjeç;
31. Raportimi i dhunës në familje;
32. Veprimtaria e shërbimeve të kujdesit parësor;
33. Veprimtaria e shërbimit stomatologjik;
34. Veprimtaria e institucioneve me shtretër;
35. Veprimtaria obstetrikale në institucionet shëndetësore ose banesë;
36. Veprimtaria e qendrave shëndetësore të specializuara ose poliklinikave;
37. Veprimtaria e shërbimit të urgjencës;
38. Veprimtaria e konsultorit të gruas;
39. Veprimtaria e konsultorit të fëmijëve;
40. Veprimtaria e laboratorit mikrobiologjik;
41. Veprimtaria e laboratorit kimik - fizik (Shëndetit Publik);

42. Veprimtaria e dispanserive antituberkulare;
43. Veprimtaria e laboratorit klinik biokimik;
44. Veprimtaria e Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut;
45. Veprimtaria e qendrave komunitare të shëndetit mendor;
